

20081422894

L I G J

PËR GARANCI TË REPUBLIKES SË MAQEDONISE NDAJ DETYRIMEVE NGA "MARREVESHJA PËR RREGULLIMIN E BORXHIT TË HEKURUDHAVE TË MAQEDONISE TRANSPORT SHA SHKUP SI TRASHEGIMTAR JURIDIK TË NP HEKURUDHAT E MAQEDONISE SHKUP NDAJ HEKURUDHAVE TË HUNGARISE MAV SA PËR PERIUDHEN 1991-1995"

Neni 1

Republika e Maqedonise e garanton permbushjen e detyrimeve në shume prej 7.716.697 euro sipas Marreveshjes për rregullimin e borxhit të Hekurudhave të Maqedonise Transport SHA Shkup si trashегimtar juridik të NP Hekurudhat e Maqedonise Shkup ndaj Hekurudhave të Hungarise MAV SA për periudhen 1991-1995 e cila do të lidhet ndermjet Hekurudhave të Maqedonise SHA Shkup dhe Hekurudhave të Hungarise MAV SA në afate dhe kushte të parapara në Marreveshjen, vetem në rastet kur Hekurudhat e Maqedonise Transport SHA Shkup nuk do t'i paguaje anuitetet e arritura.

Neni 2

Kushtet dhe menyra e garantimit të detyrimeve që burojnë nga marreveshja e nenit 1 të ketij ligji, do të percaktohen me Marreveshjen për garanci, e cila do të lidhet ndermjet Republikes së Maqedonise të perfaqesuar nga Ministria e Financave dhe Hekurudhave të Hungarise MAV SA.

Neni 3

Të gjitha detyrimet financiare që burojnë nga Marreveshja për rregullimin e borxhit nga neni 1 i ketij ligji, si dhe pagimin e anuiteteve të arritura do ta beje Hekurudhat e Maqedonise Transport SHA Shkup nga të ardhurat të cilat i realizon, në afatet dhe kushtet të percaktuara në Marreveshjen për rregullimin e borxhit.

Neni 4

Detyrimet nga Marreveshja e nenit 1 të ketij ligji do të paguhen për pese vite, me norme interesi prej 3,567% në nivel vjetor, në keste të barabarta tre mujore në pajtim me planin e pageses. Në rast të mosrespektimit të planit të pagimit, Hekurudhat e Maqedonise Transport SHA Shkup i humbin beneficinet dhe perfitimet e percaktuara në Marreveshjen e nenit 1 të ketij ligji.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndersjella, të cilat burojnë nga Marreveshja për rregullimin e borxhit të Hekurudhave të Maqedonise Transport SHA Shkup si trashегimtar juridik të NP Hekurudhat e Maqedonise Shkup ndaj Hekurudhave të Hungarise MAV SA për periudhen 1991-1995 dhe të marreveshjes për garanci, Ministria e Financave dhe Hekurudhat e Maqedonise Transport SHA Shkup do të lidhin Marreveshje të vecante për sigurimin e garancise shteterore.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazeten zyrtare të Republikes së Maqedonise".